



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr 122 , datë 29 / 07 / 2022

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRGJEDHJES SË  
ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË, SI DHE TË MËNYRËS SË  
ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË TIJ NË BASHKINË KORÇË.**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligit nr. 75/2019 “Për Rininë nen 7.1 b) dhe nenit 10 të tij, VKM nr. 681, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e krijuimit, të organizimit e të funksionimit të agjencisë kombëtare të rinisë VKM nr. 969 datë 02/12/2020 , “Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij.

VENDOSI:

**1. Të miratojë kriteret dhe procedurat e përgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor në Bashkinë Korçë si më poshtë vijon:**

- KVR-ja përbëhet nga 10 (dhjetë) anëtarë, nga të cilët, të paktën 5 (pesë) janë vajza. Anëtarët e KVR-së janë, si më poshtë vijon:
  - kryetari i bashkisë;
  - 4 (katër) përfaqësues nga organizatat rimore dhe/ose për të rinjtë;
  - 5 (katër) përfaqësues anëtarë të këhillave studentorë/qeveritë e nxënësve.
- Sekretariati i KVR-së përbëhet nga 2 (dy) anëtarë: 1 (një) personi përgjegjës për sektorin e rinisë pranë bashkisë dhe 1 (një) përzgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit (organizatat/këshillat studentor/qeveritë e nxënësve).
- Mandati i anëtarëve të KVR-së është dyvjeçar, dhe mund të rizgjidhen vetëm një herë.

- Anëtar i KVR-së mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim kryetarin. Anëtar i dorëhequr është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet e lëna deri në miratimin e urdhrit të ndryshimit.
- Anëtarët e KVR-së duhet të deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Anëtarët e KVR-së kryejnë detyrën e tyre bazuar në parimin e mosdiskriminimit, të meritës, transparencës dhe gjithëpërfshirjes.

#### **Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor të Bashkisë Korçë**

- Kandidati për anëtar të KVR-së, përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kriterë:
  - të ketë dhënë kontribut në fushën e rinashtimit përmes paktës së dyshimit, nëpërmjet projekteve me fokus rinashtimi apo të zhvillimit të nismave ose të aktiviteteve përmes promovimin e rinashtimit;
  - të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.
- Kandidati për anëtar të KVR-së, jo përfaqësues i organizatave rinoare, duhet të plotësojë këto kriterë:
  - të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - të ketë përvjetorë pune në fushën e zhvillimit apo të zbatimit të aktiviteteve rinoare, apo të ketë qenë pjesë e nismave ose aktiviteteve përmes promovimin e rinashtimit;
  - të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe të dispozitave ligjore në fuqi.
- Kandidati, për t'u emëruar anëtar i KVR-së, duhet të paraqesë, përkatesisht, dokumentacionin si vijon:
  - kandidati, përfaqësues i organizatave rinoare dhe/ose përmes rinashtimit:
    - kërkesën;
    - jetëshkrimin (CV: fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin);
    - vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
    - vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.

- NIPT të organizatës që përfaqëson.
- kandidati, jo përfaqësues i organizatave rinore:
  - kërkesën;
  - jetëshkrimin (CV: fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin);
  - vërtetimin e gjendjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
  - letër motivimi;
  - vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.

- Thirrja për kandidatët publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë: për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh. Votimi përgjedhës kryhet në formë elektronike në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e fillimit të procesit të votimit. Qytetarët do të kenë mundësinë për të zgjedhur/votuar anëtarët kandidatë nga:

- Organizatat rinore dhe/ose për të rindjtë
- Anëtarë të këshillave studentorë/qeveritë e nxënësve

Kandidatët më të votuar do mandatohen për të qënë pjesë e KVR.

## **2. Të miratojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor Rinor si më poshtë:**

- Këshilli Vendor Rinor është organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë. KVR-ja ushtron kompetencat e mëposhtme, sipas Ligji 75/2019 “Për Rininë”, neni 10, pika 1:

- këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- vlerëson situatën e të rindjeve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- propozon përmirësimë të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rindjeve në territorin ku veprojnë;
- bashkëpunon dhe shkëmbe informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

- KVR-ja mblidhet jo më pak se 3 (tri) herë në vit. Mbledhjet thirren nga sekretariati teknik. Sekretariati teknik njofton anëtarët e KVR-së, të paktën 7 (shtatë) ditë përpëra datës së përcaktuar për mbledhjen me anë të e-mail zyrtar.
- Mbledhja e KVR-së zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën gjysma (1/2) e anëtarëve të saj.
- KVR-ja mbështetet nga sekretariati teknik, i cili përbëhet nga dy anëtarë. Caktimi i anëtarëve të sekretariatit teknik e procedura e thirrjes së mbledhjes apo elemente të tjera për funksionimin e KVR-së përcaktohen në rregulloren e brendshme, e cila miratohet me më shumë se  $\frac{1}{2}$  e votave të anëtarëve.
- Në çdo mbledhje të KVR-së mbahet procesverbali që pasqyron të gjitha diskutimet gjatë mbledhjes. Procesverbali nënshkruhet nga çdo pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse të KVR-së.
- Mandati i anëtarit të KVR-së mbaron kur:
  - përfundon afati dyvjeçar nga data e emërimit;
  - humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate apo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - jep dorëheqjen.
- Anëtari i Këshillit Vendor të Rinisë lirohet nga detyra, para mandatit, nga kryesuesi i KVR me më shumë së  $\frac{1}{2}$  e votave, në rastet kur:
  - nuk paraqitet, pa shkaqe të justifikuara, në të paktën 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme të KVR-së;
  - paraqiten shkaqe objektive, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
  - nuk përmbush detyrimet si anëtar i KVR-së;
  - veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KVR-së.
- Anëtari i KVR-së, të cilit i është ndërprerë mandati apo është liruar nga detyra, zëvendësohet nga kryesuesi dhe sekretariati teknik me një kandidat që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë vendim, i cili ka qenë i kandiduar.
- Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit zëvendësues është sa pjesa e mbetur e mandatit të anëtarit të larguar.

**3. Të miratojë të detyrat dhe detyrimet e Këshillit Vendor Rinor si më poshtë:**

- Promovon projektet dhe iniciativat për të rinjtë iniciuar nga Bashkia Korçë dhe nga organizatat e shoqërisë civile;
- Këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- Vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- Nxitë takime, diskutime me të rinjtë në gjithë territorin e Bashkisë Korçë
- Propozon përmirësimë të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Korçë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI  
ERJON NEXHIPI**

